LIGJ
Nr.9955, datë 17.7.2008

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FRANCEZE PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E SIGURISË SË BRENDSHME"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Franceze për bashkëpunimin në fushën e sigurisë së brendshme".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5833, datë 29.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FRANCEZE NË LIDHJE ME BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E SIGURISË SË BRENDSHME

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Franceze, të quajtara më poshtë "Palët":

me dëshirën për të kontribuar në zhvillimin e marrëdhënieve të tyre dypalëshe në kuadrin e Traktatit të mirëkuptimit, miqësisë dhe bashkëpunimit midis Republikës Franceze dhe Republikës së Shqipërisë, bërë në Paris, më 12 dhjetor 1994;

nisur nga vullneti për të kontribuar aktivisht në luftën kundër formave të ndryshme të kriminalitetit ndërkombëtar;

me kujdesin për të kryer një bashkëpunim efikas në fushën e luftës kundër trafikut të paligjshëm të drogave dhe substancave psikotrope;

duke pasur në kujtesë Konventën e Këshillit të Europës të 28 janarit 1981 për mbrojtjen e personave nga trajnimi i automatizuar i të dhënave me karakter personal,

bien dakord si më poshtë.

Neni 1

Palët zhvillojnë një bashkëpunim teknik dhe operacional në fushën e sigurisë së brendshme dhe asistojnë reciprokisht njëra-tjetrën në fushat e mëposhtme:

1. Lufta kundër kriminalitetit të organizuar;

2. Lufta kundër trafikut të paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve të tyre kimikë;

3. Lufta kundër terrorizmit;

4. Lufta kundër shkeljeve ligjore me karakter ekonomik dhe financiar dhe pikërisht pastrimit të parave;

5. Lufta kundër trafikut të qenieve njerëzore;

6. Lufta kundër trafikut të organeve, indeve, qelizave dhe produkteve humane;

7. Lufta kundër imigracionit klandestin dhe kriminalitetit që rrjedh prej tij;

8. Siguria e mjeteve të transportit ajror, detar dhe tokësor;

9. Lufta kundër falsifikimit dhe fabrikimit të mjeteve të pagesës dhe të dokumenteve të identifikimit;

10. Lufta kundër vjedhjeve dhe trafikut të paligjshëm të armëve, municioneve, eksplozivëve dhe lëndëve bërthamore, përbërësve kimikë dhe produkteve bakteriologjike, si dhe lëndëve të tjera të rrezikshme dhe mallrave e teknologjive të përdorimit civil dhe ushtarak;

11. Lufta kundër trafikut të automjeteve të vjedhura;

12. Lufta kundër trafikut të pasurive kulturore dhe të objekteve të vjedhura të artit;

13. Policia teknike dhe shkencore;

14. Formimi i personelit.

Ky bashkëpunim mund të shtrihet në fusha të tjera që lidhen me sigurinë e brendshme pasi merret pëlqimi i ministrave të përcaktuar përgjegjës për zbatimin e kësaj Marrëveshjeve.

Neni 2

1. Tërësia e aktiviteteve të parashikuara nga kjo Marrëveshje për bashkëpunimin në fushën e sigurisë së brendshme kryhet nga Palët duke respektuar në mënyrë strikte legjislacionin kombëtar të njëra-tjetrës.

2. Secila nga Palët mund të refuzojë kërkesën për komunikim informacioni, formuluar në kuadrin e kësaj Marrëveshje nëse ajo vlerëson se në bazë të legjislacionit të saj kombëtar pranimi i kërkesës do të cenonte të drejtat themelore të personit.

3. Secila nga Palët mund të hedhë poshtë kërkesën për bashkëpunim në rrafshin teknik, ashtu dhe në atë operacional, formuluar në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, nëse ajo vlerëson se pranimi i saj do të cenonte sovranitetin, sigurinë, rendin publik, rregullat e organizimit dhe të funksionimit të autoritetit gjyqësor ose interesa të tjera thelbësore të shtetit të saj.

4. Kur, në zbatim të paragrafëve 2 dhe 3 të këtij neni, njëra nga Palët hedh poshtë kërkesën për bashkëpunim, ajo informon Palën tjetër.

Neni 3

Palët bashkëpunojnë për parandalimin dhe kërkimin e akteve të dënueshme që marrin forma të ndryshme të kriminalitetit ndërkombëtar. Për këto:

1. Palët i komunikojnë njëra-tjetrës informacione që lidhen me personat e dyshuar që marrin pjesë në forma të ndryshme të kriminalitetit ndërkombëtar, me marrëdhëniet midis këtyre personave, me strukturën, funksionimin dhe metodat e organizatave kriminale, me rrethanat e krimeve të kryera në këtë kontekst, si dhe shkeljet e dispozitave ligjore dhe masat e marra, kur kjo është e nevojshme për parandalimin e shkeljeve të tilla;

2. Secila Palë, merr, me kërkesën e tjetrës, masa policore nëse ato gjykohen të nevojshme për zbatimn e kësaj Marrëveshjeje;

3. Palët bashkëpunojnë në formën e marrjes së masave policore të koordinuara dhe të asistencës reciproke në personel dhe në teknikë, mbi bazën e marrëveshjeve shtesë të nënshkruara nga autoritetet kompetente;

4. Palët komunikojnë informacionet që lidhen me metodat dhe format e reja të

kriminalitetit ndërkombëtar. Në këtë kuadër, secila Palë mund të vërë në dispozicion të tjetrës, me kërkesën e saj, kampione ose objekte dhe informacione që lidhen me këto;

5. Palët shkëmbejnë rezultatet e kërkimeve që ato bëjnë në kriminalistikë dhe në kriminologji dhe informojnë njëra-tjetrën për metodat e hetimit dhe mjetet e luftës kundër kriminalitetit ndërkombëtar;

6. Palët shkëmbejnë specialistë me qëllim përfitimin e njohurive profesionale të nivelit të lartë dhe zbulimin e mjeteve, metodave dhe teknikave moderne të luftës kundër kriminalitetit ndërkombëtar.

Neni 4

Për të penguar kultivimin, nxjerrjen, prodhimin, importimin, eksportimin, transitimin dhe tregtimin e paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve të tyre kimikë, të dyja Palët marrin masa të koordinuara dhe procedojnë me shkëmbime:

1. informacionesh që lidhen me personat që marrin pjesë në prodhimin dhe në trafikun e paligjshëm të drogave dhe substancave psikotrope, me metodat që ata përdorin, me vendet e fshehta dhe mjetet e tyre të transportit, me vendet e origjinës, transitit, blerjen dhe destinacionin e drogave e substancave psikotrope dhe të prekursorëve të tyre dhe çdo detaj të veçantë që lidhet me këto shkelje, që mendohet se kontribuojnë për t'i parandaluar, penguar dhe për të ndihmuar në zbulimin e akteve të parashikuara nga Konventa e vetme e kombeve të bashkuara mbi drogat, e datës 30 mars 1961, ndryshuar nga Protokolli i 25 marsit 1972, Konventa mbi substancat psikotrope e datës 21 shkurt 1971 dhe Konventa mbi trafikun e paligjshëm të drogave dhe substancave psikotrope e datës 19 dhjetor 1988;

2. informacionesh operative mbi metodat aktuale të tregtisë ndërkombëtare të paligjshme të drogave dhe substancave psikotrope në përputhje me legjislacionin kombëtar të tyre;

3. rezultatesh të kërkimeve në kriminalistikë dhe në kriminologji të kryera në fushat e trafikut të paligjshëm të drogave dhe substancave psikotrope dhe të abuzimit me to;

4. kampionesh të drogave dhe substancave psikotrope dhe prekursorëve të tyre që mund të përbëjnë objekt abuzimi dhe informacionesh teknike mbi kapjet e tyre;

5. rezultatesh të përvojave që lidhen me kontrollin dhe tregtinë ligjore të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve të tyre, si dhe informacionesh operative që lidhen me to.

Neni 5

Në kuadrin e luftës kundër terrorizmit, Palët procedojnë me shkëmbime informacionesh lidhur me:

1. aktet e terrorizmit të projektuara ose të kryera, me mënyrën e ekzekutimit dhe mjetet teknike të përdorura për kryerjen e tyre;

2. grupe terroristësh dhe anëtarët e këtyre grupeve që parashikojnë, kryejnë ose kanë kryer akte terroriste në territorin e njërës nga Palët dhe cenojnë interesat e Palës tjetër.

Neni 6

Në secilën nga fushat e përmendura në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, bashkëpunimi teknik ka për objekt kryesor:

1. formimin e përgjithshëm dhe të specializuar;
2. shkëmbime informacionesh dhe përvojash profesionale;
3. këshillimin teknik;
4. shkëmbimin e dokumentacionit të specializuar;

5. në rast nevoje, pritjen reciproke të funksionarëve dhe ekspertëve.

Neni 7

Bashkëpunimi teknik që mendohet të vihet në jetë në fushat e përmendura në këtë Marrëveshje ka si objekt shkëmbime paraprake të korrespondencave midis Palëve në rrugë diplomatike. Në rast nevoje, marrëveshje teknike midis administratave të interesuara përcaktojnë modalitetet e zbatimit konkret të veprimeve që do të jenë përcaktuar.

Zbatimi i bashkëpunimit teknik përbën objektin e një programimi vjetor. Në këtë programim do të evidentohet kontributi i secilës Palë brenda limitit të burimeve të saj buxhetore. Nënshkrimi i këtij programi do të bëhet në fillim të çdo viti. Palët nënshkruese janë përkatësisht: për Palën shqiptare, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe për Palën Franceze, Atasheu i Sigurisë së Brendshme pranë Ambasadës së Republikës së Francës në Shqipëri.

Pala kërkuese siguron në të gjitha misionet e Palës së kërkuar asistencën e një interpreti.

Neni 8

Ministrat e interesuar janë përgjegjës për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Për këtë qëllim, ata do të përcaktojnë organizmat e ngarkuar me zbatimin e fushave të ndryshme të bashkëpunimit. Ky përcaktim i bëhet i ditur Palës tjetër në rrugë diplomatike.

Neni 9

Për të siguruar mbrojtjen e tyre, të dhënat me karakter pesonal që i komunikohen Palës tjetër në kuadrin e bashkëpunimit të bazuara në këtë Marrëveshje i nënshtrohen kushteve të mëposhtme:

1. Pala marrëse e të dhënave me karakter personal mund t'i përdorë ato vetëm me qëllime dhe kushte të përcaktuara nga Pala dërguese, përfshirë afatet në fund të të cilave këto të dhëna duhet të shkatërrohen.

2. Pala marrëse e të dhënave me karakter personal informon Palën dërguese, me kërkesë për përdorimin e tyre dhe rezultatet e arritura.

3. Të dhënat emërore u transmetohen vetëm autoriteteve kompetente dhe vetëm për aktivitetin në të cilin këto të dhëna janë të nevojshme. Transmetimi i këtyre informacioneve autoriteteve të tjera është i mundur vetëm pas dhënies së pëlqimit me shkrim të Palës dërguese.

4. Pala dërguese garanton saktësinë e të dhënave të komunikuara pasi sigurohet se ky komunikim është i nevojshëm dhe i përshtatshëm për objektivin e kërkuar. Nëse përcaktohet se janë transmetuar të dhëna jo të sakta ose të dhëna të pakomunikueshme, Pala dërguese informon për to menjëherë Palën marrëse, e cila korrigjon të dhënat jo të sakta ose shkatërron të dhënat e pakomunikueshme.

5. Çdo person, duke justifikuar identitetin e tij, ka të drejtën të pyesë autoritetet kompetente për të ditur nëse ato ruajnë të dhënat me karakter personal që kanë lidhje me të dhe në rast se po, t'i komunikohet për to.

6. Të dhënat me karakter personal duhet të shkatërrohen që në momentin kur Pala marrëse nuk ka më nevojë për to. Pala marrëse informon pa afat Palën dërguese për shkatërrimin e të dhënave të komunikuara duke i saktësuar asaj motivet e këtij shkatërrimi.

7. Secila Palë mban një regjistër të të dhënave të komunikuara dhe të shkatërrimit të tyre.

8. Palët marrin të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e të dhënave me karakter personal që i komunikohen atyre kundër të gjithë akseseve të paautorizuara, të gjitha modifikimeve dhe publikimeve të paautorizuara.

9. Në rast denoncimi të kësaj Marrëveshjeje ose të mosripërtëritjes së saj, të gjitha të dhënat emërore duhet të shkatërrohen menjëherë.

Neni 10

Çdo Palë garanton trajtimin konfidencial të informacioneve të klasifikuara si të tilla nga Pala tjetër.

Materiale kampione, objekte dhe informacione të komunikuara në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje nuk mund t'i transmetohen një shteti të tretë pa pëlqimin me shkrim të Palës që i ka dhënë.

Neni 11

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje rregullohet me bisedime ndërmjet Palëve.

Neni 12

Secila Palë njofton tjetrën për përmbushjen e procedurave të brendshme të kërkuara, përsa i takon asaj, për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, efektet e së cilës fillojnë ditën e parë të muajit të dytë që pason datën e marrjes së njoftimit të fundit.

Kjo Marrëveshje hartohet për një kohëzgjatje trivjeçare. Ajo ripërsëritet pa ndonjë formalitet për periudha të reja trivjeçare.

Secila Palë mund ta denoncojë këtë Marrëveshje në çdo moment nëpërmjet njoftimit me shkrim të adresuar Palës tjetër. Ky denoncim merr fuqi tre muaj pas datës së njoftimit të saj. Ai nuk cenon veprimet në realizim e sipërm, përveç rasteve kur vendoset ndryshe nga dy Palët.

Secila Palë mund ta pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, tërësisht ose pjesërisht, nëpërmjet njoftimit me shkrim dërguar Palës tjetër, me një lajmërim paraprak prej tre muajsh.

Kësaj Marrëveshjeje mund t'i bëhen ndryshime. Këto ndryshime hyjnë në fuqi në përputhje me dispozitat e paragrafit të parë të këtij neni.

Për rrjedhojë, përfaqësuesit e dy Palëve, të autorizuar sipas formave të përshkruara për këtë qëllim, kanë nënshkruar dhe vulosur këtë Marrëveshje.

Bërë në Paris, më 15.5.2008 në dy kopje, secila në gjuhët shqipe dhe frënge, të dy tekstet janë të barasvlefshme.